




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit
04 Nr. 249
Më:18/05/2022

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, Ri-ofertën me numër protokolli 1566 i dt.06.05.2022 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Kruja, Tirana, Fieri dhe qyteti i Durrësit. Ekskursioni zgjatë 4 bujtje (gjithsejtë katër bujtje, pansion i plotë) prej datës 24/05/2022 deri më 28/05/2022.

Lista e konkurrentëve për të fituar Ri-ofertën për ekskursion të maturantëve të Gjimnazit ”Hajdar Dushi” në Gjakovë:

1. SH.P.K.”Meti –Tours me çmim 110.00 €;
2. SH.P.K.”Armendi -Tours ” me çmim 115.00 € për Hotelin “Shtëpia e luleve –“Camelia” dhe 118.00€ për hotelin “Max Royal G Resort “SHPK

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.17/05/2022 në ora 14:00 sipas ofertës nr.1566 i dt.06/05/2022 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit : z.Zymer Berisha, znj.Flutur Këpuska, dhe z.Dukagjin Ademi, Përfaqësues i Këshillit Drejtues të Gjimnazit ”Hajdar Dushi” në Gjakovë, z.Fatos Axhemi dhe Drejtori i shkollës z.Bedri Cahani.

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese SHPK “Meti -Tours” ka konkuruar me çmim prej 110.00€ për nxënës, ku në këtë çmim ka ofruar që kujdestarët e klasave lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës , të gjithë nxënësit janë të liruar nga të gjitha obligimet për shfrytëzimin e plazhit dhe shfrytëzimin e pishinës brenda hotelit.

Oferta bazohet në 4 (katër) bujtje me pansion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel “Bonita Shpk” Golem -Kavajë në Durrës prej dt.24/05/2022 deri më 28/05/2022 dhe vizitat në qytetet Vlorë , Krujë , Tiranë ,Fier dhe qyteti i Durrësit. Janë të përfshirë nëntë (9) shoferë të pajisur me çertifikata mjekësore dhe janë prezantuar 9 autobusë, kanë marrëveshje bashkëpunimi me “Kushtrimi NM I”.

Firma posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2019 gjerë më dt.06/06/2024. Ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të firmës, kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, ka ofruar 3 referenca me imazh pozitiv, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, Licencën e Punës Dr.Baton Lleshi së bashku me kontratën e punës të kontraktuar

nga kompania SHPK "Meti Tours" për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturantët).

Ka prezantuar konfirmim rezervimi (parakontratën) nga administratori Astrit Ismaili të Hotelit "Bonita Shpk" Golem -Kavajë në Durrës me pronarin e SHPK "Meti Tours", Licencën e agjencionit të akreditimit të ushqimeve sipas Ri-ofertës Gjimnazit "Hajdar Dushi" me nr.prot.1566 dt.06.05.2022 pika (i) po ashtu Çertifikatën e regjistrimit të Hotelit "Bonita Shpk" Golem – Kavajë.

Firma transportuese SHPK "Armendi -Tours" ka konkuruar me çmim 115.00 € për Hotelin "Shtëpia e luleve –"Camelia" dhe 118€ për hotelin "Max Royal G Resort "SHPK për nxënës. Në ofertë përfshihen katër (4) bujtje me pansion të plotë që nga 24/05/2022 deri më 28/05/2022 dhe vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë në Vlorë, Krujë, Tiranë, Fier dhe qyteti i Durrësit dhe përzgjedhjen e ndonjë nxënësi me kushte të vështira për lirim nga pagesa gjithashtu ofron pishina të brendshme dhe të jashtme të gjitha në shërbim të nxënësve dhe stafit shkollës. Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.28/02/2022 gjer me dt.27/02/2027. Posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Gjon Komoni ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe firmës transportuese SHPK "Armendi -Tours" për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës Gjimnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë. Janë të përfshirë 10 shoferë e të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 10 autobusë. Gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të firmës dhe kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, ka ofruar 1 Referencë me imazh pozitiv, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, po ashtu ka prezentuar dy Kontrata bashkëpunimi –Konfirmim rezervimi në mes të "Max Royal G Resort "SHPK me administartor Arkenad Gripshi dhe Shtëpia e luleve –"Kamelia" SHPK me seli në Durrës e regjistruar me NIPT L21421501J me SHPK "Armendi tours" me përfaqësues Albin Gjoshi. Ka prezentuar Çertifikatë kategorizimi (struktur akomoduese) dt.12.06.2020 nr.regj.1013/2020. Firma në fjalë nuk ka prezantuar licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (neni 11 paragrafi 2.21 i UA -02/2016) sipas Ri-ofertës pika (i) të shkollës Gjimnazi "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurrese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç`rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.17.05.2022 (e Martë) iu janë prezantuar Pëlqimet e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (14 mësimdhënës).

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për shkollës Gjimnazi "Hajdar Dushi" Gjakovë të përzgjedhet firma SHPK "Meti -Tours" me çmim prej 110.00€

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike SHPK "Meti -Tours" nga Gjakova



Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (14 arsimtarë), Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 14 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë të përzgjedhet firma **SHPK “Meti -Tours” me çmim prej 110.00€** pasi ka prezantuar Licencën e agjencionit të akreditimit të ushqimeve të kërkuar në Ri-ofertën me nr.prot.1566 dt.06.05.2022 te pika (i) të Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

Komisioni selektues:

1. Bedri Cahani
(emri dhe mbiemri)

Kryesues i Komisionit dt.18/05/2022
(pozita)

2. Fatos Axhemi
(emri dhe mbiemri)

Anëtar dt.18/05/2022
(pozita)

3. Zymer Berisha
(emri dhe mbiemri)

Anëtar dt.18/05/2022
(pozita)

4. Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)

Anëtare dt.18/05/2022
(pozita)

5. Dukagjin Ademi
(emri dhe mbiemri)

Anëtar dt.13/05/2022
(pozita)

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 15 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencive turistike
- Komisionit të Ankesave
- Shërbimit juridik
- Arkivit

